



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.legjislacioni.gov.al

Nr. 46

Datë 8 prill 2014

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr. 192, datë 2.4.2014	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 48, datë 16.1.2008 të Këshillit të Ministrave “Për programin e nxitjes së punësimit të punëkërkesve të papunë në vështirësi”, të ndryshuar	1255
Vendim i KM nr. 193, datë 2.4.2014	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 47, datë 16.1.2008 të Këshillit të Ministrave “Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit në punë”, të ndryshuar	1255
Vendim i KM nr. 194, datë 2.4.2014	Për përcaktimin e masës së financimit, nga buxheti i vitit 2014, për bashkësitë fetare tradicionale që kanë nënshkruar marrëveshje me Këshillin e Ministrave	1256
Vendim i KM nr. 195, datë 2.4.2014	Për një ndryshim në vendimin nr. 42, datë 17.1.1998 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e statutit të Shërbimit Kombëtar të Punësimit”, të ndryshuar	1257
Vendim i KM nr. 196, datë 2.4.2014	Për miratimin e autorizimit për ndërtimin dhe shfrytëzimin e centralit elektrik fotovoltaik të shoqërisë “UKKO” sh.a.....	1257
Vendim i KM nr. 199, datë 2.4.2014	Për disa shtesa në vendimin nr. 480, datë 22.6.2011, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores model të planifikimit” të ndryshuar	1259

VENDIM
Nr. 192, datë 2.4.2014

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË
VENDIMIN NR. 48, DATË 16.1.2008 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR
PROGRAMIN E NXITJES SË PUNËSIMIT TË
PUNËKËRKUESVE TË PAPUNË NË
VËSHTRËSI”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4 e 8 të ligjit nr. 7995, datë 20.9.1995 “Për nxitjen e punësimit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 48, datë 16.1.2008 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Kudo në vendim, emërtimet “Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta” dhe “Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës”, zëvendësohen përkatësisht me “Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë” dhe “Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes”.

2. Pika 1 riformulohet si më poshtë vijon:

“1. Përfitues të këtij programi janë punëkërkuarit e papunë në vështirësi, të përcaktuar në pikën 3 të këtij vendimi. Zyra përkatëse e punësimit financon:

a) Punëdhënësin, me një financim mujor në masën deri në 100 për qind të kontributeve të sigurimeve të detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore (pjesë e kontributit të punëdhënësit), me kusht që kohëzgjatja e kontratës së punës të mos jetë më e shkurtër se një vit.

Ky financim bëhet nga zyra e punësimit në Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, sipas procedurave përkatëse;

b) Punëmarrësin e përfshirë në këtë program, deri në katër paga, në masën 100 për qind të pagës minimale në shkallë vendi, në muajin e pestë e të gjashtë dhe në muajin e njëmbëdhjetë e të dymbëdhjetë të kontratës, ndërsa për muajt e tjerë financon punëdhënësi.

Punëdhënësit, persona juridikë apo fizikë, kanë të drejtë të kërkojnë të përfshijnë në program:

i) deri në 100 për qind të numrit aktual mesatar të të siguruarve në tre muajt e fundit, në rast se kanë deri në 50 punonjës;

ii) deri në 50 për qind të numrit aktual mesatar të të siguruarve në tre muajt e fundit, në rast se kanë mbi 50 punonjës.”.

3. Në fund të pikës 5, shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Publikimi i programit bëhet, gjithashtu, me të gjitha mjetet e mundshme elektronike dhe joelektronike.”.

4. Në pikën 6 hiqen fjalët “... verifikuar nga Inspektorati i Punës ...”.

5. Në pikën 7 bëhen këto ndryshime:

a) Në shkronjat “a” dhe “d”, pas fjalës “... juridik ...” shtohen “... dhe fizik ...”.

b) Pas nënndarjes “v” të shkronjës “dh”, shtohet nënndarja “vi” me këtë përmbajtje:

“vi) akte të inspektimit në punë, të kryera nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe i Shërbimeve Shoqërore.”.

6. Pika 9 ndryshohet si më poshtë vijon:

“9. Punëdhënësit mund të aplikojnë për programin në mënyrë elektronike apo pranë zyrave të punësimit.”.

7. Në paragrafin e dytë të pikës 12, pas fjalës “... organizimit ...” shtohen fjalët “... vlerësimit të projekteve ...”.

8. Pika 13 ndryshohet si më poshtë vijon:

“13. Komisionet e miratimit të projekteve në zyrën rajonale të punësimit dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit vendosin miratimin ose jo të projektit brenda 10 (dhjetë) ditëve pune.”.

9. Në pikën 14 hiqen fjalët “... për një periudhë të paktën tremujore ...”.

10. Në paragrafin e dytë të pikës 16, hiqen fjalët “... në bashkëpunim me inspektoratin rajonal/vendor të punës ...”.

11. Paragrafi i parë i pikës 17, ndryshohet si më poshtë vijon:

“Në rastet kur punëkërkuari, si punëmarrës, pjesëmarrës në këtë program, largohet përpara afatit të përcaktuar në kontratë, për shkaqe të arsyeshme, zëvendësimi bëhet nga zyra përkatëse e regjistrimit pas njoftimit nga punëdhënësi.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 193, datë 2.4.2014

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË
VENDIMIN NR. 47, DATË 16.1.2008 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR
PROGRAMIN E NXITJES SË PUNËSIMIT,
NËPËRMJET FORMIMIT NË PUNË”, TË
NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, 8, 11 e 12 të ligjit nr. 7995, datë 20.9.1995 “Për nxitjen e punësimit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 47, datë 16.1.2008 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Kudo në vendim, emërtimet “Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta” dhe “Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës”, të zëvendësohen përkatësisht me “Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë” dhe me “Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes”.

2. Pika 1 ndryshohet si më poshtë vijon:

“1. Përfitues të këtij programi janë punëkërkuar të papunë, të cilët do të përfitojnë trajnim nëpërmjet punës. Zyra përkatëse e punësimit financon:

a) deri në 70 për qind të tarifave me bazë koston e trajnimit, për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme;

b) deri në 50 për qind të tarifave me bazë koston e trajnimit, për ndërmarrjet e mëdha;

c) kursantin, punëkërkuar të papunë, të përfshirë në këtë program, sipas masës së parashikuar në pikën 7 të këtij vendimi”.

3. Në fjalinë e parë të pikës 6, fjalët “... kostoja e trajnimit ...”, zëvendësohen me “... tarifat me bazë koston e trajnimit ...”.

4. Në fund të pikës 8, shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Publikimi i programit bëhet, gjithashtu, me të gjitha mjetet e mundshme elektronike dhe joelektronike.”.

5. Në shkronjën “a” të pikës 9, hiqen fjalët “... të verifikuara nga Inspektorati i Punës...”.

6. Në pikën 10 bëhen këto ndryshime:

a) Në shkronjën “a”, pas fjalës “...juridik...” shtohet “... dhe fizik ...”;

b) Në shkronjën “e”, pas nënndarjes “v” shtohet nënndarja “vi” me këtë përmbajtje:

“vi) akte të inspektimit në punë, të kryera nga Inspektorati Shtetëror i Punës.”.

7. Pika 12 ndryshohet si më poshtë vijon:

“12. Punëdhënësit mund të aplikojnë për programin në mënyrë elektronike apo pranë zyrave të punësimit.”.

8. Në paragrafin e dytë të pikës 15, pas fjalës “...organizimit...” shtohen fjalët “...vlerësimit të projekteve ...”.

9. Pika 16 ndryshohet si më poshtë vijon:

“16. Komisionet e miratimit të projekteve në zyrën rajonale të punësimit dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit vendosin miratimin ose jo të projektit brenda 10 (dhjetë) ditëve pune.”.

10. Në paragrafin e parë të pikës 17 hiqen fjalët “... për një periudhë, të paktën, tremujore ...”.

11. Në paragrafin e dytë të pikës 21 hiqen fjalët “... në bashkëpunim me inspektoratin rajonal/vendor të punës ...”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 194, datë 2.4.2014

**PËR PËRCAKTIMIN E MASËS SË
FINANCIMIT, NGA BUXHETI I VITIT 2014,
PËR BASHKËSITË FETARE TRADICIONALE
QË KANË NËNSHKRUAR MARRËVESHJE ME
KËSHILLIN E MINISTRAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 4 e 6 të ligjit nr. 10140, datë 15.5.2009 “Për financimin nga buxheti i shtetit të bashkësive fetare tradicionale që kanë nënshkruar marrëveshje me Këshillin e Ministrave”, të nenit 5 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të ligjit nr. 185/2013, datë 30.12.2013 “Për buxhetin e vitit 2014”, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Masa e financimit prej 108 900 000 (njëqind e tetë milionë e nëntëqind mijë) lekësh, nga buxheti i shtetit i vitit 2014, i miratuar për të mbështetur financiarisht bashkësitë fetare, përdoret sipas ndarjes së mëposhtme:

a) Komuniteti Mysliman i Shqipërisë përfiton shumën 31 416 000 (tridhjetë e një milionë e katërqind e gjashtëmbëdhjetë mijë) lekë, të ndarë përkatësisht:

i) 11 748 000 (njëmbëdhjetë milionë e shtatëqind e dyzet e tetë mijë) lekë, për financimin me gjysmën e pagës minimale buxhetore për 89 punonjës të administratës;

ii) 19 668 000 (nëntëmbëdhjetë milionë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë) lekë, për financimin me gjysmën e pagës minimale buxhetore për 149 punonjës të institucioneve të arsimit parashkollor, parauniversitar dhe universitar.

b) Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë përfiton shumën 25 872 000 (njëzet e pesë milionë e tetëqind e shtatëdhjetë e dy mijë) lekë, të ndarë përkatësisht:

i) 20 592 000 (njëzet milionë e pesëqind e nëntëdhjetë e dy mijë) lekë, për financimin me gjysmën e pagës minimale buxhetore për 156 punonjës të administratës;

ii) 5 280 000 (pesë milionë e dyqind e tetëdhjetë mijë) lekë, për financimin me gjysmën e pagës minimale buxhetore për 40 punonjës të institucioneve të arsimit parashkollor, parauniversitar dhe universitar.

c) Kisha Katolike në Shqipëri përfiton shumën 25 872 000 (njëzet e pesë milionë e tetëqind e shtatëdhjetë e dy mijë) lekë, të ndarë:

i) 5 676 000 (pesë milionë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë) lekë, për financimin me gjysmën e pagës minimale buxhetore për 43 punonjës të administratës;

ii) 20 196 000 (njëzet milionë e njëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë) lekë, për financimin me gjysmën e pagës minimale buxhetore për 153 punonjës të institucioneve të arsimit parashkollor, parauniversitar dhe universitar.

ç) Kryegjyshata Botërore Bektashiane përfiton shumën 25 740 000 (njëzet e pesë milionë e shtatëqind e dyzet mijë) lekë, të ndarë:

i) 3 696 000 (tre milionë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë) lekë, për financimin deri në gjysmën e pagës minimale buxhetore për 28 punonjës të administratës;

ii) 15 044 000 (pesëmbëdhjetë milionë e dyzet e katër mijë) lekë, për ndërtimin e Selisë së Shenjtë të Kryegjyshit të Botërore Bektashiane (Odeonit);

iii) 7 000 000 (shtatë milionë) lekë, për shkak të pozitës së veçantë, si Kryegjyshit të Botërore me qendër në Tiranë dhe të shtrirjes së veprimtarisë së saj jashtë vendit, që do të përdoret për të mbuluar plotësisht ose pjesërisht kërkesëpreventivat e paraqitur prej saj në kërkesën e vitit 2014, sipas dokumentacionit financiar të paraqitur për kryerjen e veprimtarive të parashtruara.

2. Kalimi i fondit të bëhet brenda muajit prill të vitit 2014.

3. Ngarkohen Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Ministria e Financave dhe Komiteti Shtetëror për Kultet për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 195, datë 2.4.2014

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 42,
DATË 17.1.1998 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STATUTIT
TË SHËRBIMIT KOMBËTAR TË PUNËSIMIT”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 17 të ligjit nr. 7995, datë 20.9.1995 “Për nxitjen e punësimit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 12 i statutit të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, miratuar me vendimin nr. 42, datë 17.1.1998 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet si më poshtë vijon:

“Neni 12

Këshilli Administrativ Trepalësh është organi më i lartë vendimmarrës i Shërbimit Kombëtar të Punësimit. Ai përbëhet nga 9 anëtarë dhe kryesohet nga ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë. Anëtarët e tjerë janë përfaqësues të Ministrisë së Financave, Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Inspektoratit Shtetëror të Punës, Institutit të Sigurimeve Shoqërore, organizatave më të përfaqësuara të punëmarrësve në këshill, me dy anëtarë, dhe të organizatave më të përfaqësuara të punëdhënësve në këtë këshill, me dy anëtarë. Mandati i anëtarëve të këtij këshilli është trevjeçar dhe miratimi i emërimit të këtyre anëtarëve bëhet nga ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë. Përfaqësuesit e institucioneve shtetërore duhet të jenë në nivel zëvendësministri ose drejtori drejtorie. Shpërblimi për pjesëmarrjen në mbledhjet e këshillit bëhet sipas legjislacionit në fuqi. Këshilli ushtron veprimtarinë e tij sipas rregullores së funksionimit të tij.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 196, datë 2.4.2014

**PËR MIRATIMIN E AUTORIZIMIT PËR
NDËRTIMIN DHE SHFRYTËZIMIN E
CENTRALIT ELEKTRIK FOTOVOLTAIK TË
SHOQËRISË “UKKO” SHA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 34/1 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe të vendimit nr. 1701, datë 17.12.2008 të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e dhënies së autorizimeve për ndërtimin e objekteve të reja gjeneruese të energjisë, që nuk janë objekt koncesioni”, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e autorizimit për ndërtimin dhe shfrytëzimin e centralit elektrik fotovoltaik të shoqërisë “UKKO” sh.a., sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Energjisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ENERGJISË DHE INDUSTRIJË

AUTORIZIM

Nr. _____, datë _____.2014

**PËR NDËRTIMIN E CENTRALIT ELEKTRIK
FOTOVOLTAIK NGA SHOQËRIA UJËSJELLËS-
KANALIZIME KORÇË**

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 34/1 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe në mbështetje të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1701, datë 17.12.2008 “Për miratimin e rregullores për procedurat e dhënies së autorizimeve, për ndërtimin e objekteve të reja gjeneruese të energjisë që nuk janë objekt koncesioni”,

Duke pasur parasysh se:

a) Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Korçë sh.a. (UKKO sh.a.) është pajisur me autorizimin paraprak nr. 1, datë 25.3.2014 prej MEI-t, për ndërtimin e centralit elektrik fotovoltaik në Rajonin nr. 1, Blloku i Ri i Sportit, Korçë;

b) UKKO sh.a. ka paraqitur studimin e plotë të fizibilitetit teknik, ekonomik, financiar dhe mjedisor e social, bazuar në të dhëna të zonës së zbatimit të projektit;

c) UKKO sh.a. ka paraqitur planin e biznesit të projektit;

d) UKKO sh.a. ka paraqitur grafikun e zbatimit të projektit;

e) “CEZ Shpërndarje” sh.a. ka miratuar pikën e lidhjes me rrjetin e shpërndarjes;

f) UKKO sh.a. ka paraqitur raportin e vlerësimit të ndikimit në mjedis, i cili në bazë të ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit”, nuk kërkon pajisjen me leje mjedisore të tipave A, B dhe C;

g) UKKO sh.a. ka paraqitur dokumentacionin që provon të drejtat e pronësisë mbi tokën që do të përdoret për ndërtimin e burimit gjenerues të energjisë.

Ministria e Energjisë dhe Industrisë autorizon shoqërinë UKKO Korçë, e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, me nr. NUIS J641031410, me seli në Korçë, në adresën: Rajoni nr. 1, Blloku i Ri i Sportit, rruga “Boris Pëllumbi”, Korçë, për ndërtimin e centralit elektrik fotovoltaik në përputhje me kushtet dhe karakteristikat e mëposhtme:

1. Vendndodhja e centralit elektrik fotovoltaik është e vendndodhur brenda sipërfaqes së specifikuar me dokumentacionin e paraqitur në MEI.

2. UKKO sh.p.k. autorizohet për ndërtimin e centralit elektrik fotovoltaik me karakteristikat e mëposhtme:

a) fuqi të instaluar rreth 1 MW;

b) prodhimtari të pritshme totale të energjisë elektrike prej 1336 MWh/vit;

c) numri total i moduleve fotovoltaike është 4180 copë;

d) sipërfaqja e një moduli është 1,64 m² ;

e) fuqia mesatare e një moduli 240 Wp;

f) modulet do të jenë të grupuara në 190 blloqe me nga 22 module secili;

g) sipërfaqja brenda së cilës do të ndërtohet centrali është 23000 m² .

3. Shoqëria UKKO sh.a. do të përfundojë ndërtimin e centralit elektrik fotovoltaik brenda 12 (dymbëdhjetë) muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

4. UKKO sh.a. do të paraqesë brenda në MEI projektin e plotë të zbatimit teknik brenda një periudhe prej 1 (një) muaji nga data e hyrjes në fuqi e këtij autorizimi.

5. UKKO sh.a. është e detyruar të raportojë çdo muaj pranë MEI-t mbi ecurinë e ndërtimit të centralit elektrik fotovoltaik, duke filluar nga data e fillimit të ndërtimit. MEI ka të drejtë t'i kërkojë UKKO sh.a. çdo informacion që e konsideron të nevojshëm lidhur me zbatimin e kushteve të këtij autorizimi.

6. Brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi e këtij autorizimi, midis UKKO sh.a. dhe MEI-t do të nënshkruhet një kontratë lidhur me afatet e realizimit dhe penalitetet në rast mosrealizimi në kohë apo transferimi të autorizimit.

7. UKKO, në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1701, datë 17.12.2008 “Për miratimin e rregullores për procedurat e dhënies së autorizimeve, për ndërtimin e objekteve të reja gjeneruese të energjisë që nuk janë objekt koncesioni”, do t'i paguajë çdo vit ministrisë përgjegjëse për energjinë një *royalty* të barabartë me 2% të sasisë së energjisë vjetore të prodhuar nga centrali fotovoltaik ose, vlerën në lek të kësaj sasive energjie së bashku me çdo përfitim aksesor të shoqërisë në lidhje me sasinë e *royalty* prej 2%, efektivisht të përfituar në bazë të incentivave të tregut të energjisë së rinovueshme.

8. Shoqërisë i rezervohet një zonë buferike me një rreze prej 50 metrash nga kufiri i centralit sipas koordinatave të zonës ku pozicionohen komponentët.

9. Autorizimi mund të revokohet nga ministria përgjegjëse për energjinë në rastet e mëposhtme:

a) me kërkesë me shkrim të UKKO sh.a. për raste të veçanta të justifikuara;

b) UKKO sh.a. nuk respekton detyrimet dhe kriteret e përcaktuara në këtë autorizim dhe brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga njoftimi prej ministrisë përgjegjëse për energjinë, nuk paraqet arsyet justifikuese të dokumentuara për mosrealizimin dhe nuk merr masat e nevojshme për të përmbushur detyrimet përkatëse;

c) UKKO sh.a. nuk informon MEI-n mbi arsyet që mund të shpien në vonesa ndaj realizimit të ndërtimit të paktën 60 (gjashtëdhjetë ditë) përpara periudhës së përfundimit të afatit të ndërtimit;

d) Vërtetohet se deklaratimet e UKKO sh.a. nuk janë të vërteta;

e) Kur për UKKO sh.a. kanë filluar procedurat e falimentimit ose të likuidimit, sipas ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002 “Për falimentimin”;

f) UKKO sh.a., për arsye të shkaktuara nga ajo vetë, nuk ka respektuar programin e punimeve, dhe brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga njoftimi prej ministrisë përgjegjëse për energjinë, nuk paraqet arsyet për mosrealizimin e detyrës dhe nuk paraqet masat që do të ndërmarë për të përfunduar centralin elektrik fotovoltai në datën e përcaktuar;

g) UKKO sh.a. nuk respekton detyrimin për informimin dhe nëse brenda një afati prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, pas njoftimit paraprak nga MEI për mosdhënie informacioni, përsëri nuk dërgon informacionin e kërkuar;

h) Në të gjitha rastet e tjera, të parashikuara nga vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 1701, datë 17.12.2008 “Për miratimin e rregullores për procedurat e dhënies së autorizimeve, për ndërtimin e objekteve të reja gjeneruese të energjisë që nuk janë objekt koncesioni”.

10. Kohëzgjatja e këtij autorizimi është 25 vjet, duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të këtij autorizimi.

11. Ky autorizim hyn në fuqi pas miratimit nga Këshilli i Ministrave.

12. Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

VENDIM

Nr. 199, datë 2.4.2014

PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR. 480, DATË 22.6.2011, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES MODEL TË PLANIFIKIMIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6 të nenit 88 të ligjit nr. 10 119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në shtojcën 1 “Rregullorja model e planifikimit”, seksioni 2 “Rastet e zbatimit, kushtet dhe rregullat e përdorimit të kësaj rregulloreje”, që i bashkëlidhet vendimit nr. 480, datë 22.6.2011, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, pas shkronjës “ç” të pikës 1 të

nenit 4, shtohen shkronjat “d” dhe “e”, me këtë përmbajtje:

“d) Zhvillimin e strukturave me funksion prodhues, industrial, përfshirë këtu edhe ato me material porosites, ndërtime të mbështetura nga programe kombëtare investimesh, prodhimi, përpunimi dhe distribucionesh bujqësore e blegtorale të ndryshme.

e) Lejet e ndërtimit për kategoritë e përcaktuara në këtë nen, edhe nëse janë në zonat e pezulluara, jepen nga bashkitë dhe komunat, por pasi të jetë shprehur më parë AKPT-ja dhe duke vënë në dijeni Këshillin Kombëtar të Territorit për konformitetin e lejes me instrumentet kombëtare dhe/ose vendore të planifikimit të miratuara ose në proces.”.

2. Procedurat e hollësishme për zbatimin e këtij vendimi përcaktohen me udhëzim të ministrit të Zhvillimit Urban dhe Turizmit.

3. Ngarkohen autoritetet e planifikimit, të përcaktuara në nenet 5 e 12 të ligjit nr. 10 119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, të ndryshuar, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet për 6 (gjashtë) muaj nga hyrja në fuqi të tij.

**KRYEMINISTRI
Edi Rama**

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare me çmimin 16 000 lekë ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare me çmimin 14 000 lekë (ky çmim nuk përfshin shpërndarjen në adresë)

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2014

Çmimi 8 lekë

Adresa: bulevardi "Gjergj Fishta", pas ish-ekspozitës "Shqipëria Sot",
Tel: 04 24 27 005, 04 24 27 006